



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravlja / Ministry of Health	
Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale / Kosovska Agencija za Medicinske Proizvoda / Kosovo Medicines Agency	
Nr. i fletës / Broj stranice / No. Pages: 29 -	Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.: 01 / 1252/4
Data / Datum / Date: 02.05.2024	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravlja / Ministry of Health
Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale / Kosovska Agencija za Medicinske Proizvoda / Kosovo Medicines Agency

Nr.154/V/2024

Datë: 02.05.2024

Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale në bazë të Nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, zv. Kryeshefi Ekzekutiv i AKPPM – së, nxjerr:

V E N D I M

1. Miratohet Plani i Integritetit i hartuar nga Grupi Punues, i caktuar me Vendimin Nr. 148/IV/2024 i datës 24.04.2024.
2. Znj. Nadire Lleshi – Udhëheqëse e Divizionit të Produkteve Medicinale me Emra të Mbrojtur Gjenerik, caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

A r s y e t i m

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit.

Në kuadër të kësaj, sipas udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të Metodologjisë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 26.07.2023, Zv. Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencionit të Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) nxjerr vendim për miratimin e Planit të Integritetit, të hartuar nga grupi punues, i caktuar me Vendim nr. 148/IV/2024, datë 24.04.2024, të theksuar si në pikën 1 të dispozitivit të Vendimit.

Znj. Nadire Lleshi, sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit, i cili monitoron procesin sipas planit të integritetit, zbatimin e masave të përmirësimit nga institucioni, përgatit treguesit për vlerësimin e efikasitetit dhe vlerësimin e rezultateve të masave të propozuara për përmirësimin e integritetit.

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Zy. Kryeshefi Ekzekutiv i AKPPM – së

Sejdë Tolaj




Vendimi iu dorëzohet:

- *Kryeshefit të AKPPM-së;*
- *Anëtarëve të Grupit Punues;*
- *Personit përgjegjës;*
- *Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit*
- *Arkivit të AKPPM-së.*



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravlja / Ministry of Health

PLANI PËR INTEGRITET (2024 – 2026)

Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale – AKPPM

Agencija za Lekove i Medicinske Proizvode –ALMP

Kosove Medicines Agency -KMA

PËRMBAJTJE

1. Hyrja.....	3
2. Deklarata e Integritetit.....	4
3. Parimet e menaxhimit të Integritetit.....	5
3.1 Lidershipi.....	5
3.2 Përfshirja e personelit.....	5
3.3 Qasja sistemore.....	5
4. Objektivat e Planit të Integritetit.....	5
5. Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit.....	6
5.1 Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit.....	6
5.2 Metodologjia e vlerësimit të rrezikut.....	7
5.2.1 Matrica vlerësimit të rrezikut.....	7
5.2.2 Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut.....	7
6. Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi.....	8
7. Fusha e rrezikut.....	8
7.1 Fushat e përgjithshme të Rrezikut.....	8
7.2 Fushat specifike të rrezikut.....	8

1. Hyrja

Në pajtim me nenin 25, pika 1 të Ligjit nr.08/I-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në përputhje me “Metodologjinë e Planeve të Integritetit” të cilat obligojnë të gjitha institucionet të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (referuar AKPPM) me datën 02.05.2024, ka hartuar Planin e Integritetit për periudhën 2024 -2026.

Plani i integritetit është një dokument i brendshëm tre (3) vjeçar dhe përditësohet çdo vit. Është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cënueshmërisë së integritetit brenda Institucionit dhe që ofron masa për menaxhimin e integritetit për të arritur objektivat e integritetit të Institucionit.

Plani rritet përkushtimin e AKPPM-së për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet brenda fushëveprimit të AKPPM-së.

Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të insitucionit dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

2. Deklarata e Integritetit

Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale - AKPPM, në vazhdimësi ka bërë përpjekje për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve publike me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ne gjithashtu e kuptojmë mirë mandatin tonë për ta luftuar korrupsionin. Drejtuesit e AKPPM janë të vendosur të zbatojnë me vendosmëri politikën “zero tolerancë” ndaj korrupsionit, mashtrimit, keqadministrimit apo çdo shkelje tjetër e integritetit.

Ne, do të bëjmë përpjekje të vazhdueshme të përcaktojmë ekspozimet e mundshme të organeve të AKPPM-së, kushteve të tyre organizative, proceseve dhe punonjësve, ndaj korrupsionit dhe sjelljeve tjera të kundërligjshme dhe jo etike. Përmes planit të integritetit, ne eliminojmë shkaqet e korrupsionit të cilat mundësojnë forcimin e sundimit të ligjit dhe besimin e qytetarëve në punën e organeve të administratës AKPPM-së.


Të gjithë ne jemi përgjegjës për parandalimin efikas, zbulimin me kohë dhe hetimin e korrupsionit, mashtrimit apo çdo shkeljeje tjetër të integritetit në AKPPM. Ne jemi të vendosur që në realizimin e mandatit dhe detyrave tona të veprojmë ndershëm, guximshëm, të matur, moralshëm, drejtë dhe me profesionalizëm. Të mos keqpërdorim asnjëherë detyrën zyrtare si dhe qasjen e besuar në resurset publike, për çfarëdo përfitimi personal apo për të tjerët.

Të ndërmarrim të gjithë hapat e nevojshëm për të parandaluar dhe zgjidhur çfarëdo konflikti real, të dukshëm apo potencial të interesit ndërmjet përgjegjësive tona zyrtare dhe çështjeve tona private në të mirë të interesit publik. Të përmbahemi nga përfshirja në çfarëdo biznesi apo transaksioni apo nga të pasurit e çfarëdo interesi financiar apo interesi tjetër personal, që është apo mund të jetë në mospërputhje me kryerjen e detyrave zyrtare. Të shmangim nepotizmin dhe favorizimin në punësim dhe ofrimin e shërbimeve. Të përmirësojmë konsiderueshëm politikën tona parandaluese të korrupsionit duke zbatuar me përpikëri planin e integritetit. Të përmbahemi nga çfarëdo sjellje që mund të humbë integritetin e AKPPM-së.

Andaj, unë deklaroj përkrahjen time të plotë dhe përkushtimin tim maksimal për të gjitha përpjekjet që fuqizojnë, zhvillojnë dhe përmirësojnë vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit brenda AKPPM-së.

Kryeshefi i AKPPM – së

PHD Mr.sci **Sejdë TOLAJ**



3. Parimet e menaxhimit të Integritetit

3.1 Lidërshipi

Menaxhmenti i lartë duhet në mënyrë të dukshme të demonstrojë një përkushtim aktiv të bazuar në fakte për integritetin. Kjo do të kërkonte nga ata që të udhëheqin procesin qysh nga fillimi, përmes zhvillimit të politikave të integritetit. Është shumë e rëndësishme që ky përkushtim të jetë i vazhdueshëm në mënyrë që të kuptohet dhe të shihet mirë nga të gjitha palët e interesit, të jashtme dhe të brendshme.

3.2 Përfshirja e personelit

Është shumë e rëndësishme pjesëmarrja e secilit punëtor në zbatimin e suksesshëm të sistemit për menaxhimin e integritetit. Megjithatë, përfshirja kuptimplote kërkon edukimin e përshtatshëm dhe trajnimin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me integritetin, ngritjen e vetëdijes duke krijuar kështu besim dhe mjedis pozitiv për punë. Komunikimi efektiv i jashtëm dhe i brendshëm dhe koordinimi janë të rëndësishme për punë të suksesshme ekipore në mënyrë që të gjitha palët e përfshira të marrin dhe të mbajnë të njëjtin kuptim për projektin derisa është duke u zbatuar.

3.3 Qasja sistemore

Identifikimi i fushave potenciale të korrupsionit dhe menaxhimi i proceseve të ndërlidhura për të siguruar integritet kërkon qasje sistemore. Kërkohet nga organizatat që të kushtojnë vëmendje të gjitha komponentëve të sistemit dhe të analizojnë marrëdhënien dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre.

4. Objektivat e Planit të Integritetit

Objektivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë përpjekjet dhe burimet për të zvogëluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike dhe jo profesionale në AKPPM.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një platforme ku të gjithë zyrtarët, njësitë në AKPPM, si dhe personat fizik dhe juridik të cilët mund të përfshihen në luftën kundër korrupsionit, sjelljeve jo etike dhe veprimeve jo profesionale;
- Rritja e vetëdijes së zyrtarëve mbi rreziqet e korrupsionit, sensibilizimi i qytetarëve për rolin e tyre në zvogëlimin/eliminimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo etike dhe veprimeve jo profesionale;
- Përmirësimi i raportimit të rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në AKPPM;
- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve nga ana e AKPPM ndaj sektorit publik dhe privat;

- Rritja e besueshmërisë, reputacionit dhe parandalimit të mashtrimit;
- Krijimi dhe mirëmbajtja e partneriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike dhe veprimeve jo profesionale si dhe forcimi i sundimit të ligjit.

5. Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument që vlerëson ligjshmërinë e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve, ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe / ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i cënueshmërisë të identifikuar dhe të vlerësuar për të gjitha fushat e funksionimit të AKPPM-së.
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar cënueshmërinë e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësit për zbatimin e këtyre masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit bëhet vlerësimi i cënueshmërisë së integritetit për të gjitha fushat e funksionimit. Të gjithë të punësuarit kanë pasur mundësi të marrin pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të AKPPM-së, të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin, cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

5.1 Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa fazave si në vijim:

- **Faza e parë:** Me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv është emëruar grupi punues për hartimin e Planit të Integritetit të AKPPM-së, ku janë përfshirë të gjithë udhëheqësit e njësisë organizative të AKPPM-së si dhe me vendim është emëruar Kordinatori i Integritetit. Grupi punues ka shqyrtuar dhe analizuar bazën ligjore mbi hartimin, monitorimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit, gjithashtu grupi punues është dakorduar për agjendën deri në miratimin e Planit të Integritetit, ku janë përfshirë fazat e analizimit, konsultimit dhe miratimit.
- **Faza e dytë:** Grupi punues ka analizuar pyetëSORIN dhe ka shtrirë diskutimin mbi bazën e tij. Nga të dhënat e nxjerra prej pyetëSORIT janë përcaktuar fushat specifike dhe të përgjithshme të rrezikut dhe janë identifikuar rreziqet e integritetit të AKPPM-së. Në një takim të grupit punues janë përcaktuar rreziqet me prioritet dhe vendosur masat për parandalimin e tyre.
- **Faza e tretë:** Në një takim të veçantë grupi punues ka finalizuar të gjitha rreziqet dhe masat e vendosura në plan duke i përcaktuar përgjegjësit dhe periudhen kohore të zbatimit. Drafti fillestar është shpërndarë për një konsultim të përgjithshëm tek të gjithë stafi i AKPPM-së, para miratimit nga Kryeshefi Ekzekutiv.

5.2 Metodologjia e vlerësimit të rrezikut

Metoda e Vlerësimit të rreziqeve përcakton probabilitetin e shfaqjes dhe pasojave të cenimit të integritetit dhe formave të tjera të sjelljes së kundërligjshme ose jo etike.

Përmes vlerësimit të rrezikut përcaktohet mundësia e ndodhjes dhe niveli i pasojës, i cili mund të jetë: i ulët/i mesëm/i lartë. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet sipas matricës së rrezikut, në formën e një kombinimi mes mundësisë dhe pasojës.

5.2.1 Matrica vlerësimit të rrezikut

Matrica e vlerësimit të rrezikut mundëson të llogaritet rreziku në fushat apo aktivitetet e AKPPM-së për një kohë shumë të shpejtë, duke identifikuar të gjitha veprimet /mosveprimet që mund të kenë pasojë duke peshuar dëmin e mundshëm. Kjo e bën më të lehtë prioritizimin e çështjeve dhe ndërmarrjen e veprimeve, masave aty ku është më e nevojshme për të mbajtur fushat apo aktivitetet e Institucionit brenda kornizave ligjore.

Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut

Pasoja /Ndikimi	Madhor	10																		
		9																		
		8																		
	Mesatar	7																		
		6																		
		5																		
		4																		
	Vogël	3																		
		2																		
		1																		
Intenziteti i rrezikut (gjasat X ndikimi)		Ulët			Mesatar				Lartë											
		Probabiliteti/Gjasat																		

Intenziteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasojë (1-10)", treguar në figurën si më lartë.

5.2.2 Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të dëmtimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15 pikë	16 - 48	49 - 100

- Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.
- Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.
- Rreziku me intensitet të lartë – korrupsioni ose format e tjera të cenimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

6. Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga zyrtari përgjegjës brenda Institucionit dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në hartim ashtu edhe në zbatim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe Plani i Integritetit është ndjekur.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e Planit të Integritetit nga zyrtari përgjegjës brenda AKPPM - së, raporti duhet të dërgohet për vlerësim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit në përputhje me metodologjinë për Planin e Integritetit.

7. Fushat e rrezikut

7.1 Fushat e përgjithshme të Rrezikut

Fushat e përgjithshme të rrezikut shembull janë:

- Burimet Publike dhe Menaxhimi i Financave Publike;
- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore;
- Siguria e teknologjisë së informacionit.

7.2 Fushat specifike të rrezikut

Fushat e specifike të rrezikut shembull janë:

- Autorizim Marketingu;
- Licencimi;
- Farmakovigjilenca;
- Laboratori i kontrollimit të cilësisë;
- Prokurimi Publik dhe Menaxhimi i Kontratave.

Planit i Integritetit

Fushat e përgjithshme të rrezikut


Regjistrimi i rrezikut		Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut			
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
BURIMET PUBLIKE DHE MENAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE	Planifikimi jo adekuat buxhetit vjetor	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Ligji i Buxhetit Vjetor	3	8	24	Përfshirja e të gjitha njësive në fazën e planifikimit vjetor të buxhetit.	Zyra e Financave	TM2 Çdo vit
	Shpenzimi i buxhetit jo në mënyrë adekuate.		3	9	27	Hartimi i planit të shpenzimeve vjetore buxhetore.	Zyra e Financave	TM4 Çdo vit
						Hartimi i planit të prokurimit	Zyra e Financave	TM4 Çdo vit
						Harmonizimi i planit të rrjedhës së parash me planin e prokurimit	Zyra e Financave	TM4 Çdo vit

	Mungesa e transparencës në shpenzimet buxhetore.	3	8	24	Publikimi i raporteve financiare dhe planit të shpenzimeve	Zyra e Financave	TM1, TM2, TM3 DHE TM4 Çdo vit
	Mos raportimi i rregullt financiar	2	9	18	Hartimi i raporteve periodike dhe vjetore	Zyra e Financave	TM1, TM2, TM3 DHE TM4 Çdo vit
MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE.	Mungesa e stafit të mjaftueshëm për realizimin e detyrave konform afateve ligjore	8	10	80	Kërkesat(përmes Ministrisë së Shëndetësisë për Ministrinë e Financave) për staf shtesë të prezantuar në KASH dhe qarkoret buxhetore, bazuar në nevojën e implementimit të Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale 04/ L-190 , Ligjin për Barna Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekursorë Nr.02/L-128.	ZKA, Zyra e Burimeve Njerëzore	Çdo vit
	Profesionalizmi dhe kompetenca e pamjaftueshme e të punësuarve.	8	8	64	Vlerësimi objektiv për rezultatet e punës së zyrtarëve brenda viti Te behet analiza e nevojave për trajnime Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarve	Zyra e Burimeve Njerëzore, Të gjitha njësit	Çdo vit

SIGURIA E TEKNOLOGJISE SE INFORMACIONIT	Pasiguria e sistemit "BARNATARI"	Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale	9	8	72	Të hartohet procedurë standarde e operimit për sistemin "BARNATARI"	Të gjitha njësitet organizative	Gjatë vitit 2024	
						Ngritja e kapaciteteve hardverike/ softverike dhe mirëmbajtja e sistemit	IT dhe ZKA	Gjatë vitit 2024	
Fushat e veçanta të rrezikut									
Regjistrimi i rrezikut									
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut			
			Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	
AUTORIZIM MARKETINGU	Mos përputhshmëria dhe qëndrueshmëria në veprime me rastin e shqyrtimit të aplikimeve për të njejtin produkt nga zyrtarë të ndryshëm	Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale	4	10	40	Monitorimi përmes sistemit "BARNATARI"	ZKA dhe Drejtori i Departamentit	TM1, TM2, TM3 dhe TM4	

LICENCIMI	Tejkalimi i afateve në lëshimin e lejeve të importit për produktet dhe pajisjet medicinale	Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale, dhe Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative.	3	10	30	Monitorimi përmes sistemit "BARNATARI"	ZKA dhe Drejtori i Departamentit	TM1, TM2, TM3 dhe TM4
FARMAKOVIGJILENCA	Mos raportimi i duhur i efekteve anore nga profesionistët shëndetsor dhe vlerësimi jo adekuat	Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale	5	9	45	Sensibilizimi përmes fushatës informuese nga AK.PPM	ZKA dhe Drejtori i Departamentit	Gjatë vitit 2024
LABORATORI PER KONTROLLIN E CILESISE	Mos realizimi i planit vjetor të analizave si pasoj e mungesës së mostrave.	Ligji për Produkte dhe Pajisje Medicinale	9	9	81	Inicimi i ndyshimit dhe plotësimit të udhëzimit administrativ për lehtësimin e marrjes së mostrave nga AK.PPM	LKC AK.PPM	Dorëzimi i draftit në TM1

PROKURIMI PUBLIK DHE MENAXHIMI I KONTRATAVE	Mos inicimi me prioritet i procedurave të cilat lidhen me furnizimin e Banderolave	Ligji për Prokurim Publik	5	10	50	Kordinimi i njësisë kërkuese me Prokurimin për inicimin e procedurës me kohë	DABF dhe Prokurimi	TM2 Çdo vit
--	---	------------------------------	---	----	----	--	-----------------------	-------------



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravlja / Ministry of Health
Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale/Kosovska Agencija za Medicinske
Proizvoda/Kosovo Medicines Agency

Nr.148/IV/2024

Datë: 24.04.2024

Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale në bazë të Nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, zv. Kryeshefi Ekzekutiv i AKPPM – së, nxjerr:

V E N D I M

I . Caktohet Grupi Punues për hartimin e Planit të Integritetit, në përputhje me përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, me përbërjen si në vijim:

- 1. Nadire Lleshi – kryesuese**
- 2. Driton Bajramaj – anëtar**
- 3. Dukagjin Zabergja – anëtar**
- 4. Bashkim Sadiku – anëtar**
- 5. Haki Ejupi – anëtar**
- 6. Lutfi Mulaku – anëtar**
- 7. Arian Ahmeti – anëtar**
- 8. Bersan Kolgeci – anëtar**
- 9. Yll Gashi – anëtar**
- 10. Sevdije Rushiti – anëtare**
- 11. Arnesa Hyseni – anëtare**

II . Obligohet grupi Punues të përgatisë një program për hartimin e Planit të Integritetit, përmes së cilit do të informojë punonjësit për qëllimin, rëndësinë dhe mënyrën e hartimit të Planit të Integritetit, do të vlerësojë gjendjen aktuale të funksionimit të institucionit dhe do të analizojë masat ekzistuese për menaxhimin e rrezikut të korrupsionit, do të vlerësojë intensitetin e rrezikut të korrupsionit, do të propozojë afate dhe persona përgjegjës për zbatimin e masave përmirësuese që ulin rrezikun e korrupsionit, si dhe do të informojnë

punonjësit për situatën në institucion duke vlerësuar intensitetin e rrezikut të korrupsionit dhe planin e zbatimit të masave përmirësuese. Grupi Punues mund të përfshijë punonjës të tjerë të institucionit në hartimin e Planit të Integritetit.

III. Grupi i Punës përfundon hartimin e Planit të Integritetit jo më vonë se pesë (5) ditë pune.

IV. Personi përgjegjës për miratimin e Planit të Integritetit është znj. Nadire Lleshi.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

A r s y e t i m

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit. Prandaj, duke e marrë parasysh rëndësinë dhe qëllimin e hartimit dhe të miratimit të Planit të integritetit, si një dokument i cili paraqet rezultatin e vetëvlerësimit të ekspozimit të institucionit ndaj korrupsionit dhe formave tjera të cenimit të integritetit, qëllimi i të cilit është të ruajë dhe përmirësojë integritetin e institucionit duke thjeshtuar procedurat, duke forcuar llogaridhënien, kontrollin e kompetencat diskrecionale, edukimin, forcimin e etikës, krijimin e një sistemi efektiv kontrolli dhe eliminimin e praktikave joefikase. Grupi punues si në pikën 1 të dispozitivit të këtij Vendimi, është përgjegjës që gjatë punës së tij të ketë parasysh të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë të përcaktuara si në pikën 2 të dispozitivit, si dhe të veprojë sipas udhëzimeve dhe procedurave standarde të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit. Me qëllim të krijimit të një mekanizmi institucional, i cili do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të funksionimit të institucionit, nga se u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sejdë Tolaj

Zv. Kryeshëf i AKPPM-së.

Vendimi iu dërgohet:

- Kryeshëfit të AKPPM-së;
- Kryesueses dhe Anëtarëve të Grupit Punues;
- Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit
- Arkivit të AKPPM-së.

**SHTOJCA NR.4- PROCESVERBALI I MBLEDHJES SË GRUPIT PUNUES PËR
HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT**

Data e takimit: 26/04/2024

Vendi: Hotel&Restorant "Trofta"

Pjesëmarrja: Nadire Lleshi, Driton Bajramaj, Sevdije Rushiti, Bashkim Sadiku, Dukagjin Zabërgja, Haki Ejupi, Lutfi Mulaku, Arian Ahmeti, Bersan Kolgeci, Yll Gashi, Arnesa Hyseni, Sadri Rrmoku dhe Mirlinda Ahmeti.

Takimi filloi në orën: 09:15h

Rendi i ditës (agjenda) :

09:15-12:00 Fillimi i takimit të grupit punues rreth hartimit të planit të integritetit të AKPPM-së;

12:00-13:00 Pauzë për drekë;

13:00-14:30 Vazhdimi i takimit dhe përgaditja e parimeve dhe procesit të zhvillimit dhe monitorimit të planit institucional të integritetit;

14:30-14:50 Pauzë për kafe;

14:50-16:30 Finalizimi i draftit të integritetit të AKPPM-së.

Grupi punues vazhdoi punën në tabelën e fushave të përgjithshme të rrezikut për secilën njësi, edhe në këtë takim anëtarët diskutuan në lidhje me nivelin e lartë të rreziqeve mënyrën se si të përmirësohen në të ardhmën.

Grupi punues punoi për të identifikuar rreziqet për: Siguria e sistemit Barnatari, Autorizim Marketingu, Farmakovigjilenca, Laboratori i Kontrollit të Cilësisë, Prokurimit.

Takimi përfundoi në ora 16:30

Koordinator i grupit punues



SHTOJCA NR.4- PROCESVERBALI I MBLEDHJES SË GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT

Data e takimit: 25/04/2024

Vendi: Hotel&Restorant "Trofta"

Pjesëmarrja: Nadire Lleshi, Driton Bajramaj, Sevdije Rushiti, Bashkim Sadiku, Dukagjin Zabërgja, Haki Ejupi, Lutfi Mulaku, Arian Ahmeti, Bersan Kolgeci, Yll Gashi, Arnesa Hyseni, Sadri Rrmoku.

Takimi filloi në orën: 10:00h

Rendi i ditës (agjenda) :

10:00-12:00 Fillimi i takimit të grupit punues rreth hartimit të planit të integritetit të AKPPM-së;

12:00-13:00 Pauzë për drekë;

13:00-14:30 Vazhdimi i takimit dhe përgaditja e parimeve dhe procesit të zhvillimit dhe monitorimit të planit institucional të integritetit;

14:30-14:50 Pauzë për kafe;

14:50-16:30 Vazhdimi i takimit të grupit punues.

Eksperti nga USAID prezntoi draft planin e përgaditjes dhe metodologjisë së planit të integritetit për institucionin tonë AKPPM.

Prezentimi vazhdoi nga Kryeshefi Ekzekutiv duke cekur arsyen dhe pikat që duhet të përmbahen.

z. Ejupi, prezntoi se si objektiv specifik të fillohet duke u bazuar në misionin e AKPPM-së.

Grupi punues diskutoi për mënyrën e zvoglimit, eliminimit të korrupsionit dhe sjelljeve joetike ku përfshihen zyrtarët e AKPPM-së.

U diskutua për mekanizmat e krijimit të vetëdijës mbi rreziqet e korrupsionit, vlerat etike dhe profesionale.

Faza e parë: Grupi vazhdon diskutimin në lidhje me pytësorin i cili ceket në draft planit të integritetit, si dhe propozon që me Vendim nga Kryeshefi Ekzekutiv të emërohet grupi punues për hartimin e planit të integritetit për AKPPM-në, ku në grup duhet përfshirë të gjithë udhëheqësit e njësive organizative të AKPPM-së. Gjithashtu me vendim të emërohet dhe kordinatori i integritetit.

Grupi punues ka shqyrtuar dhe analizuar bazën ligjore mbi hartimin, monitorimin dhe zbatimin e planit të integritetit.

Gjithashtu grupi punues është dakorduar në lidhje me agjendën deri në miratimin e planit të integritetit ku është përfshirë faza e analizimit, konsultimit dhe miratimit.

Faza e dytë: Grupi punues ka analizuar pytësonin dhe ka shtrirë diskutimin mbi bazën e tij. Nga të dhënat e nxjerra prej pytësonit janë përcaktuar fushat specifike dhe të përgjithshme të rrezikut dhe janë identifikuar rreziqet e integritetit për AKPPM-në. Në një takim të grupit punues janë përcaktuar rreziqet në prioritet dhe vendosur masat për parandalimin e tyre.

Faza e tretë: Në një takim të veçant, grupi punues ka finalizuar të gjitha rreziqet dhe masat e vendosura në plane duke i përcaktuar përgjegjësit dhe periudhen kohore të zbatimit. Drafti fillestar është shpërndarë për një konsultim të përgjithshëm tek të gjithë nëpunësit e institucionit para miratimit nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Përfaqësuesi i USAID shpjegoi se si mbushet tabela e vlerësimit të rrezikut dhe për nivelin e pasojave në të ardhmën, nga kush monitorohet plani i integritetit si dhe se ku duhet të dërgohet raporti i vlerësimit në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Fushat e përgjithshme janë: menaxhimi i burimeve njerëzore, burimet publike dhe Menaxhimi i financave publik, siguria e teknologjisë së informacionit.

Fushat specifike janë: autorizim marketingu, licencimi, laboratorit të cilësisë, farmakovigjilenca, prokurimi publik dhe menaxhimi i kontratave.

Grupi punues punon në tabelën e fushave të përgjithshme të rrezikut.

Data e mbledhjes së radhës: 26/04/2024

Takimi përfundoi në ora 17:30.



Koordinator i grupit punues

[Handwritten signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO Ministria e Shëndetësisë - Ministry of Health Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale/Kosovska Agencija za Medicinske Proizvoda/Kosovo Medicines Agency			
Niviu Org Org. Jeshil Org. Urtir	01	Nr. Prot. B. Prot. Prot. Nr.	779
Nr. i fletës Regjistritiv No. fletës	02	Data Emitimit Data	28.02.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale/Kosovska Agencija za Medicinske Proizvoda/Kosovo Medicines Agency

Nr.104/II/2023

Datë:28.02.2023

Zv.Kryeshefi i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 01 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), në pajtim me nenin 5 (paragrafi 5.4. c) të Rregullores 2001/19 për Degën e Ekzekutivit, bazuar në Ligjin Nr.08/L-017 Për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nxjerr këtë:

V E N D I M

për emërimin e zyrtarës përgjegjëse

- I. Emerohet zyrtarja përgjegjëse për planin e integritetit në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe pajisje Medicinale.
- II. Zyrtarja përgjegjëse nga AKPPM është si në vijim:
 - 2.1. Znj. Nadire LLeshi caktohet zyrtare përgjegjëse e planit të integritetit në AKPPM.
- III. Zyrtarja përgjegjëse e planit të integritetit në AKPPM kryen detyrat e saj bazuar në legjislacionin në fuqi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi datën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në KPMSHCK, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Më qellim të mbarëvajtjes dhe zhvillimit normal të procesit të punës, sipas legjislacionit në fuqi, zv.Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale në pajtim me autorizimet dhe përgjegjësitë e parapara ligjore vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Nadire LLeshi;
- DABF-së;
- Arkivës.



SHTOJCA NR. 5 – NJOFTIM PËR PUNONJËSIT

Të nderuar,

Ju njoftojmë se **AKPPM** (emri i institucionit) ka filluar hartimin e Planit të Integritetit, sipas Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (*Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022*), Nenit 25 të Ligjit, lidhur me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale, për miratimin e Planeve të Integritetit. Prandaj në raport me obligimet tona brenda afateve të përcaktuara ligjore, për hartimin e planeve të integritetit, afati i fundit për hartimin e Planit të Integritetit është 30.04.2024

Duke e marrë parasysh konceptin dhe qëllimin e hartimit të Planit të Integritetit, i cili është një dokument që paraqet rezultatin e vetëvlerësimit të institucionit, ekspozimit ndaj rreziqeve të shfaqjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe parregullsive të tjera, krijimi i një mekanizmi të tillë do të sigurojë efikasitet dhe efektivitet në funksionimin e institucionit, rritje të përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë, thjeshtim të procedurave të komplikuara, rritje të transparencës dhe llogaridhënie në vendimmarrje, kontrollin e kompetencave diskrecionale, forcim të etikës, eliminimin e praktikave joefikase dhe rregulloreve të pazbatueshme, duke ndërtuar kështu një sistem efikas të mbikëqyrjes dhe kontrollit.

Hartimi i Planit të Integritetit do të kryhet në tre faza:

Faza e parë është faza përgatitore në të cilën drejtuesi i institucionit merr vendim për hartimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit dhe cakton një koordinator, anëtarë të Grupit të Punës dhe një person përgjegjës për zbatimin e planit të integritetit.

Faza e dytë ka të bëjë me vlerësimin e gjendjes aktuale në fushat e institucionit të ekspozuara ndaj rrezikut dhe zhvillimin e praktikave të papranueshme nga pikëpamja etike dhe profesionale, korruptive dhe parregullsive tjera. Faza e vlerësimit përfshin përcaktimin e ekzistencës së masave të duhura për eliminimin e rrezikut të korrupsionit, duke përfshirë edhe punonjësit në institucion.

Faza e tretë ose faza përfundimtare është projektuar për të përcaktuar masat, afatet dhe personat përgjegjës për zbatimin e masave. Pas miratimit të Planit të Integritetit, titullari i institucionit cakton një person përgjegjës për zbatimin e tij. Personi përgjegjës monitoron procesin, efikasitetin dhe rezultatet e zbatimit të masave të propozuara për integritetin e institucionit.

Më 25.04.2024, filluam fazën e parë të hartimit të Planit të Integritetit, duke miratuar vendimin për hartimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit dhe emërimin e anëtarëve të Grupit Punues. Anëtarët e emëruar të Grupit Punues janë:

-

-

Grupi Punues do të përgatisë një program për hartimin e Planit të Integritetit, do të informojë punonjësit për qëllimin, rëndësinë dhe mënyrën e zhvillimit të Planit të Integritetit, si dhe vlerësimin e gjendjes aktuale të ekspozimit të rrezikut në fushat e funksionimit të institucioneve.

Në fazën e vlerësimit të ekspozimit të institucionit ndaj rreziqeve të shfaqjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe parregullsive të tjera, në rast të propozimit të masave dhe aktiviteteve të përshtatshme shtesë për reduktimin dhe eliminimin e rreziqeve të identifikuara, koordinatori i Grupit Punues mund të përfshijë punonjës nga fushat e funksionimit të institucionit.

Në hartimin e Planit të Integritetit, është e rëndësishme të sigurohet pjesëmarrja e punonjësve për faktin se ata e njohin funksionimin e proceseve të punës që kryejnë dhe mund të vlerësojnë rreziqet në mënyrën më të mirë dhe propozojnë masat adekuate për parandalimin dhe eliminimin e tyre.

Gjatë fazës së dytë, punonjësit dhe zyrtarët do të plotësojnë një pyetësor anonim i cili do të përcaktohet më vonë.

(Vendi dhe data)

Grupi Punues do të përgatisë një program për hartimin e Planit të Integritetit, do të informojë punonjësit për qëllimin, rëndësinë dhe mënyrën e zhvillimit të Planit të Integritetit, si dhe vlerësimin e gjendjes aktuale të ekspozimit të rrezikut në fushat e funksionimit të institucioneve.

Në fazën e vlerësimit të ekspozimit të institucionit ndaj rreziqeve të shfaqjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe parregullsive të tjera, në rast të propozimit të masave dhe aktiviteteve të përshtatshme shtesë për reduktimin dhe eliminimin e rreziqeve të identifikuara, koordinatori i Grupit Punues mund të përfshijë punonjës nga fushat e funksionimit të institucionit.

Në hartimin e Planit të Integritetit, është e rëndësishme të sigurohet pjesëmarrja e punonjësve për faktin se ata e njohin funksionimin e proceseve të punës që kryejnë dhe mund të vlerësojnë rreziqet në mënyrën më të mirë dhe propozojnë masat adekuate për parandalimin dhe eliminimin e tyre.

Gjatë fazës së dytë, punonjësit dhe zyrtarët do të plotësojnë një pyetësor anonim i cili do të përcaktohet më vonë.

(Vendi dhe data)